



This project is funded
by the European Union



RBMT

River Basin Management & Transparency

Uji është jetë

Përfshihu në debat

This project is implemented by association "Une, Gruaja" and is supported by Milieukontakt Macedonia, ICID and IECE with Funds of European Union. Grant contract number RBMT2018/395-890/Sub_G010



IECE
INSTITUTE FOR
RESEARCH IN ENVIRONMENT
CIVIL ENGINEERING AND ENERGY

Banorë të Pogradecit!

Në këtë kohë pandemie na është thënë: "Lani duart shpesh!" Dhe ne hapim rubinetin e ujit, që të mbrojmë shëndetin tonë sepse të gjithë e dimë që uji është jetë.

Ne e përdorim ujin për të pirë, për të gatuar, për të bërë dush, për të larë rrobat, për të ujitur lulet, për bujqësinë, për prodhimin e sigurt të ushqimeve tona, për industrinë, për prodhimin e energjisë, për habitatet e kafshëve, shpendëve...


Jetojmë në një qytet të bekuar nga Natyra. Pogradeci është qyteti i kaltër, qyteti i Liqenit, qyteti i lumenjve dhe bën pjesë në dy basene ujorë Drin-Bunë dhe Shkumbini.

Por si po i menaxhojmë ne këto pasuri ujore?

Shoqata "Unë, Gruaja" ka marrë një iniciativë për të qenë pjesë e Planit të Menaxhimit të Baseneve Ujorë, që të japë informacion dhe të përfshijë sa më shumë banorë e aktorë lokalë në vendimet që merren, si gjatë përgatitjes së planeve, po ashtu edhe gjatë zbatimit të tyre.

Ne duam që të gjithë së bashku, publiku i gjerë, autoritetet lokale dhe shoqëria civile të ekuilibrojnë prioritetet mjedisore, ekonomike dhe sociale në këto plane, nën moton "Zotër të ujit, Zotër të mirëqenies sonë!"

Shoqata "Unë, Gruaja"



Territori i Shqipërisë, në funksion të menaxhimit të burimeve ujore, ndahet në shtatë basene ujore.

Pogradeci është pjesë e dy baseneve:

- Baseni ujor Drin-Bunë, me qendër në Shkodër.
- Baseni ujor Shkumbin, me qendër në Elbasan.



Një detyrë e përbashkët: Pjesëmarrja e publikut në Planifikimin e Menaxhimit të Baseneve Lumore

Qytetarët evropianë duhet të luajnë një rol kryesor në zbatimin e Direktivës Kuadër të Ujit. Direktiva kërkon që publiku të informohet dhe të përfshihet në përgatitjen e planeve të menaxhimit të baseneve lumore, të cilët identifikojnë masat për të përmirësuar cilësinë e ujit. Kontributi publik do të ndihmojë Shtetet Anëtare të ekuilibrojnë përparësitë mjedisore, ekonomike dhe sociale në këto plane.

Për të siguruar pjesëmarrjen e publikut dhe palëve të interesuara në hartimin dhe përditësimin e planeve të menaxhimit të baseneve lumore, direktiva thekson se është e nevojshme të jepet informacioni i duhur për publikun mbi masat e planifikuara, përpara se të miratohen vendimet përfundimtare për masat. Për më tepër, duhet të mundësohet akses për të gjitha dokumentet dhe informacionin e përdorur për hartimin e Planit të Basenit Lumor.

Pasi plani të jetë përfunduar, autoritetet duhet të raportojnë mbi progresin e zbatimit të tij tek publiku dhe palët e interesuara.

Pjesëmarrja e publikut përfshin të gjithë përdoruesit e ujit, organizatat joqeveritare,

të tilla si grupet lokale dhe kombëtare të mjedisit, dhe palët e tjera të interesit.

Organizatave kryesore dhe grupet e qytetarëve, që mund të preken nga plani duhet të identifikohen dhe të përfshihen. Në disa raste, të tilla si në distrikte të mëdha ose gjeografikisht të ndryshme, autoritetet mund të dëshirojnë të përdorin mekanizma konsultimi për basene specifike.

Direktiva Kuadër e Ujit

Direktiva Kuadër e Ujit përcakton një kornizë ligjore për mbrojtjen dhe rikthimin e ujërave të pastra në të gjithë Evropën dhe siguron përdorimin afatgjatë dhe të qëndrueshëm të ujit.

Direktiva përcakton një qasje inovative për menaxhimin e ujërave bazuar në basenet lumore, njësitë natyrore gjeografike dhe hidrologjike dhe përcakton afate specifike për Shtetet Anëtare të BE për të arritur objektiva ambicioze mjedisore për ekosistemet ujore.

Direktiva adreson ujërat e brendshëm sipërfaqësorë, ujërat e ndërmjetëm, ujërat bregdetarë dhe ujërat nëntokësorë.

Neni 14 i Direktivës mbulon informimin dhe konsultimin me publikun.

Çfarë nënkuptojmë me pjesëmarrjen e publikut?

Pjesëmarrje e publikut nënkupton dhënien e mundësisë publikut dhe palëve për të ndikuar në rezultatet e planeve dhe më tej proceset e zbatimit. Pjesëmarrja e publikut është një nga të drejtat që rrjedh nga Konventa e Aarhus-it.

Pjesëmarrja realizohet përmes mekanizmave të konsultimit që përdorin organet qeveritare për t'u konsultuar me njerëzit dhe organizatat apo palët e interesit për të përfituar nga njohuritë dhe përvoja e tyre dhe për të zhvilluar së bashku zgjidhjet e problemeve. Konsultimi mund të jetë ose me shkrim, forma themelore e konsultimit, ose verbal, ku publiku dhe grupet e interesit diskutojnë çështjet në një takim të hapur me autoritetet. Përdoren shpesh të dyja metodat.

Kur konsultimi funksionon mirë, publiku dhe grupet e interesit marrin pjesë në mënyrë aktive në zhvillimin dhe zbatimin e planeve të baseneve lumore. Kjo çon në vendimmarrje të përbashkëta, ku ata bëhen bashkërisht përgjegjës për rezultatin e një plani.

Diskutimet publike rrisin vetëdijen për problemet kryesore që ndikojnë në mjedisin ujor dhe mënyrat për t'i adresuar ato.

Konventa e Aarhus-it

Konventa për të drejtën e publikut për informacion, pjesëmarrje në vendimmarrje dhe të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, për çështje që lidhen me mjedisin i jep një sërë të drejtash publikut:

1. E drejta për të pasur akses në informacionin mbi mjedisin në dokumentet që përgatiten nga autoritetet;
2. E drejta për të marrë pjesë në vendimet e marra nga këto autoritete që ndikojnë mjedisin, dhe
3. E drejta për të rishikuar dhe kundërshtuar ligjërisht vendime të tilla.



Pjesëmarrja e publikut në Pogradec

Për vlerësimin e problematikave për menaxhimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve ujore organizata "Unë, Gruaja" përgatiti një pyetësor, i cili mblodhi vlerësimin dhe mendimin e 310 banorëve të zonave përreth 4 lumenjve në Pogradec, Lumin e Qytetit, Lumin e Rëmenjit, Lumin e Vërdovës dhe Lumin e Çërravës.

Së bashku me anëtarët e grupit lokal të veprimit u zhvilluan:

-8 takime me komunitetin për identifikimin e problematikave në zonat përkatëse përgjatë secilit lumë, nëpërmjet diskutimeve dhe mbushjes së pyetësorëve. U kontaktuan më shumë se 160 persona.

-3 takime me biznesin për të identifikuar mënyrat sesi bizneset mund të mbështesin iniciativa të vogla miqësore me mjedisin për qëndrueshmërinë dhe menaxhimin më efektiv të burimeve ujore. U kontaktuan 40 persona, gra e burra.

-4 takime me peshkatarët për të identifikuar problemet e ndotjes së liqenit nga pellgjet e lumenjve, cilët janë ndotësit më të mëdhenj dhe më të rrezikshëm për liqenin dhe speciet e tij" etj. U kontaktuan rreth 40 peshkatarë.

Gjithashtu janë ngritur Kënde Informuese në të gjithë zonën, nga Lini deri në Çërravë dhe komuniteti ka marrë informacion për nismën, si dhe ka adresuar problematika mjedisore.



Fakte - Gjetje - Përfundime

- Lumenjtë kanë humbur zonën e tyre sensitive. Shtimi i peshkut, folenizimi i zogjve pengohet nga ndotjet që bëhen në lumë nga ujërat e zeza dhe hedhja e mbeturinave.

- Në fshatin Peshkëpi funksionon akoma landfilli i vjetër ku herë pas here hidhen mbetje urbane dhe inerte, gjë që sjell rrezik për ujërat nëntokësore dhe prish cilësinë e jetës.

- Lumi i Çërravës kërcënohet nga sterilet që mbeten nga punimet që kryejnë firmat, të cilat e shfrytëzojnë lumin për prodhimin e rërës.

- Pyjet në të gjithë basenin lumor të zonës së Pogradecit, dëmtohen nga prerja e paligjshme e pemëve.

- Tokat buqësore të refuzuara, që nuk punohen janë burim erozioni.

- Në të gjithë lumenjtë e basenit lumor si Lumi i Qytetit, Lumi i Vërdovës, Lumi i Çërravës, Lumi i Rëmenjit, derdhen ujëra të zeza.

- Fshati Rëmenj është i rrezikuar nga përmbytja dhe Lumi i Rëmenjit rrezikohet nga rrëshqitja e dherave që shkaktohet nga ndërtimi i rrugës Qafë - Plloçë - Qukës.

- Burimet e Lumit të Rëmenjit, që ndodhen në zonën e Gurit të Rrëzhanit janë të rrezikuara.

- Lumi i Vërdovës është lumi më i ndotur në zonën e Pogradecit. Ai ka cilësi të keqe të ujërave, ku nevoja biokimike për oksigjen dhe përmbajtja e lartë e amoniakut kërkojnë të merren masa të menjëhershme.

- Në pjesën e lumit mbi fshatin Vërdovë depozitohen mbetje që vijnë nga qyteti.

- Lumi i Vërdovës mbushet nga inertet e gurores në fshatin Vërdovë.

- Prita që është ndërtuar për sterilet e minierës në lumin e Vërdovës, është e mbushur dhe jashtë funksionit.

- Burimet e Kabashit janë të keqpërdorura.

- Lagjia Gurore i derdh ujërat e zeza direkt në lumin e qytetit.

- Në tregun e qytetit është një tualet publik në kushte skandaloze të higjienës.

- Në fshatin Lin, ujërat e zeza derdhen direkt në Liqen.

- Ndotja e bregut të liqenit në vijën Pogradec-Lin me mbetje urbane, inerte dhe ujëra të zeza, dëmton peshkun, turizmin dhe cilësinë e jetës së banorëve të zonës.



Planifikimi për përdorimin e burimeve ujore



Sondazhi vërtetoi që përpjekja për ndërgjegjësimin e qytetarëve vlen dhe është tejet e rëndësishme.

Pavarësisht se mbi 2/3 e të intervistuarve raportuan se nuk ishin pjesë e proceseve planifikuese për përdorimin e burimeve ujore, më shumë se gjysma e tyre (52.6%) u shprehën se dëshirojnë të jenë pjesë dhe se do të kontribuonin aktivisht nëse njoftoheshin, kundrejt një pjese të vogël, që pavarësisht dëshirës, nuk kishin kohë apo mundësinë për të marrë pjesë.

Ndihet mosbesimi tek 30% e të anketuarve, të cilët nuk janë të gatshëm të marrin pjesë, sepse nuk besojnë se ia vlen të japësh mendime kur ato nuk merren për bazë.

Ne identifikuam problematikat e ndryshme, si dhe krijuam ura komunikimi me banorët në shërbim të ndërgjegjësimit të tyre për çështjet mjedisore.

“Unë, Gruaja” po organizon takime dhe tryeza të përbashkëta pune me grupin lokal të veprimit për hartimin e rekomandimeve.

Adresimi i këtyre çështjeve tek pushteti lokal, avokimi i vazhdueshëm i të gjithë aktorëve dhe komunitetit, ndihmon në zgjidhjen e tyre.



Projekti: Transparencë për planet e Menaxhimit të Baseneve Ujorë **-Shoqëria Civile në veprim**

ZOTËR TË UJIT




Zotër të mirëqenies sonë



Shoqata "Unë Gruaja" Tel: 083222140 / Cel 0676470005

  Shoqata Une, Gruaja

 une_gruaja@yahoo.com

 www.unegruaje.org.al

Kjo broshurë u realizua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e saj është përgjegjësi e Shoqatës "Unë, Gruaja" dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

This publication was produced with the financial support of the European Union. Its contents are the sole responsibility of "Unë, Gruaja" and do not necessarily reflect the views of the European Union.